


DIALOGU KOSOVË - SERBI GJATË LEGJISLATURËS SË SHITATË TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Dhjetor 2019 – Janar 2021

MARS 2021



DIALOGU KOSOVË - SERBI GJATË LEGJISLATURËS SË SHTATË TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Dhjetor 2019 – Janar 2021

MARS 2021

Layout and design: **envinion**

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit **"Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi"** i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	6
HYRJE	8
1 DIALOGU NË SEANCAT E KUVENDIT	9
2 MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NË SEANCA	11
2.1 INTERPELANCAT	11
2.2 DEBATET PARLAMENTARE.....	12
2.3 RAPORTIMET DHE INFORMIMET E KRYEMINISTRIT.....	13
2.4 PYETJET PARLAMENTARE.....	13
3 DIALOGU NË KOMISIONET PARLAMENTARE	14
SHTOJCË.....	21



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Diskutimet rreth dialogut Kosovë-Serbi mbizotëruan diskutimet e legjislaturës së shtatë të Kuvendit ashtu siç kishte ndodhur dhe gjatë legjislaturës paraprake. Tema e dialogut vazhdoi të ishte shkas për debate të ashpra në mes të grupeve parlamentare në Kuvend. Pavarësisht thirrjeve për konsensus politik, gjatë kësaj legjislature polarizimi i tejkajshëm politik karakterizoi debatin në Kuvend lidhur me këtë çështje.

Dialogu u bë shkak kryesor që çoi në prishjen e koalicionit qeverisës mes LVV-së e LDK-së që kishte dal nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Mospajtimet mes partnerëve të koalicionit lidhur me masat e reciprocitetit rezultuan me mocion të mosbesimit në Kuvend ndaj Qeverisë Kurti dhe zgjedhjen e një Qeverie të re të udhëhequr nga LDK me Kryeministër Avdullah Hoti.

Zhvillimet e reja rreth dialogut pasuan me kërkesa të njëpasnjëshme për llogaridhënie ndaj qeverisë Hoti, kërkesa këto që vinin kryesisht nga subjekti tashmë opozitar LVV. Edhe pse kryeministri Hoti iu përgjigj ftesave në raportim dhe interpelancave të ftuara, informacionet e ofruara ishin të përgjithshme duke mos ofruar detaje mbi diskutimet e bëra apo temat konkrete që palët ishin dakorduar të bisedonin. Ndërsa sa i përket marrëveshjet së Uashingtonit të arritur në shtator 2020 në Shtëpinë e Bardhë, deputetët e Kuvendit u njoftuan me përmbajtjen e së njëjtës vetëm pas arritjes së saj. Duke qenë që kjo marrëveshje në fakt përbënte zotime të njëanshme të secilës palë, ky dokument nuk u soll në Kuvend për ratifikimin duke mos marr karakterin e një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Pavarësisht seancave të veçanta për gati secilën temë që ishin pjesë e zotimeve të Uashingtonit, mënyra se si këto çështje u shtjelluan nga të gjitha palët në debatet parlamentare e interpelancat ishin më shumë sipërfaqësore dhe për konsum publik.

Pikat e marrëveshjes së Uashingtonit si çështja e Ujmanit kërkonin hulumtim dhe ekspertizë të cilën deputetët nuk e siguruan përmes resurseve të Kuvendit apo të jashtme. Në këto rrethana mbeti në diskrecionin e përfaqësuesve të Qeverisë se sa informacione i ofronin deputetëve lidhur me këto tema në seanca dhe raportimeve në komisionet parlamentare relevante.

Në aspektin e shifrave, çështje që kanë të bëjnë me dialogun Kosovë-Serbi u ngritën në 27 nga 72 seancat e mbajtura gjatë legjislaturës së shtatë apo 38% e tyre. Diskutimet rreth dialogut kishin në fokus ndër të tjera çështjet që ndërlidhjen me: fatin e personave të zhdukur, marrëveshjen e Uashingtonit, problemet me kthim në prona të banorëve shqiptarë në pjesën veriore të vendit, raportin e punës 100 ditëshe të Qeverisë 'Hoti', reciprocitetit me Serbinë në raport me situatën me pandeminë, si dhe kërkesa për zgjedhje të reja para vazhimit të mëtejme të dialogut.

Rregullorja e Punës së Kuvendit ofron një kuadër mjaft të gjerë të mekanizmave mbikëqyrës që deputetët kanë në dispozicion për të ushtruar mbikëqyrjen parlamentare. Përgjithësisht, forma më e përdorur për mbajtjen e ekzekutivit llogaridhënës në raport me dialogun ishin interpelancat, debatet parlamentare, raportimet e kryeministrit dhe pyetjet parlamentare. Gjatë legjislaturës së shtatë u mbajtën pesë debate parlamentare rreth dialogut, gjashtë interpelanca dhe u parashtruan vetëm 7 pyetje parlamentare rreth çështjeve të ndërlidhura me dialogun. Iniciativat e deputetëve si rezolutat për dialogun nuk u materializuan si pasojë e mungesës së harmonizimit mes grupeve parlamentare që rezultoi me mungesë të kuorumit. Sidoqoftë, rezoluta e vetme rreth dialogut që u miratua nga Kuvendi ishte ajo e sponsorizuar nga LVV dhe LDK, kur të njëjtat ishin në koalicion qeverisës që përcaktonte që Qeveria



duhet të udhëheq me këtë proces si dhe parimet e gjëra negociuese të cilat palës kosovare.

Në anën tjetër, në komisionet parlamentare dinamika e diskutimit rreth dialogut ishte më e ulët në krahasim me diskutimet e mbajtura në seancat plenare. Nga gjithsej 263 mbledhje të komisioneve të mbajtura gjatë kësaj legjislature, tema e dialogut u ngrit në 38 prej tyre apo 14%. Gjatë periudhës sa zgjati kjo legjislaturë komisionet ftuan në raportim katër përfaqësues të qeverisë dhe organizuan tri vizita në terren për çështje që ndërlidhen me procesin e dialogut me Serbinë.

Komisionet të cilat e trajtuan më së shumti temën e dialogut kësaj periudhe ishin Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë dhe Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike. Ndërsa kjo temë nuk u trajtua fare nga dy komisione, ai për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komisioni për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media.

Duhet nënvizuar që mbarëvajtja e punës së Kuvendit të Kosovës u ndikua nga pandemia Covid-19 duke pamundësuar në raste të caktuara organizimin e seancave të rregullta apo dhe takimeve të komisioneve parlamentare. Kjo ndikoi dhe në ushtrimin e rolit mbikëqyrës të këtij institucioni ndaj proceseve të ndryshme përfshirë dhe çështjen e dialogut.

Duke pasur parasysh këto zhvillime rreth dialogut Kosovë-Serbi gjatë legjislaturës së shtatë dhe me qëllim fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj këtij procesi, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme për Legjislaturën e re:

- Kuvendi i Kosovës duhet të jetë aktiv në ushtrimin e mbikëqyrjes efektive të procesit të dialogut Kosovë-Serbi, duke ftuar në raportim të rregullt ekzekutivin, si dhe të gjitha institucionet apo mekanizmat shtetëror të përfshira në procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Kuvendi i Kosovës duhet të dëshmojë konsistencë duke i trajtuar në vazhdimësi këto çështje mbi bazën e mandatit të tij kushtetues dhe mekanizmave mbikëqyrës që ka në dispozicion. Ndërsa komisionet parlamentare duhet të përfshihen në temat të cilat bien në fushëveprimin e tyre.

- Deputetët apo grupet parlamentare të cilat propozojnë rezoluta rreth procesit të dialogut duhet të bëjnë më shumë përpjekje që t'i harmonizojnë të njëjtat me grupet e tjera parlamentare duke synuar ndërtimin e konsensusit politik.

- Deputetët e Kuvendit duhet të shfrytëzojnë më shumë burimet e brendshme të Kuvendit që janë në dispozicion të tyre përmes Drejtoria për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv dhe ato të jashtme që mund të ofrohen nga sektori jo qeveritar, për të siguruar informacione dhe ekspertizën e duhur sa i përket temave të ndërlidhura me dialogun;

- Komisionet parlamentare duhet të vazhdojnë praktikën e mirë të organizimit të takimeve koordinuese lidhur me dialogun, si platformë diskutimi dhe bashkërendimi në mes tyre për ushtrimin e rolit mbikëqyrës ndaj dialogut, me qëllim të avancimit të transparencës së këtij procesi.

- Komisionet parlamentare duhet të synojnë që të ndërlidhin më shumë iniciativat rreth dialogut të cilat trajtohen në komisione me iniciativat që adresohen në seanca. Në këtë drejtim, informacionet që sigurohen nga raportimi i përfaqësuesve të qeverisë në komisione apo vizitat në terren, duhet të vijojnë me sigurimin e informacioneve shtesë përmes organizimit të debateve parlamentare, interpellancave, pyetjeve parlamentare apo draftimit të rezolutave rreth çështjeve në fjalë. Për një transparencë dhe llogaridhënie të shtuar.

- Komisionet parlamentare duhet të përfshijnë në planet e punës së tyre mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe institucioneve zbatuese të marrëveshjeve me anë të raportimeve të rregullta. Komisionet parlamentare duhet të organizojnë vizita në terren dhe në institucionet përgjegjëse për të monitoruar nga afër zbatimin e marrëveshjeve, ngecjet në proces dhe masat që duhet të ndërmerren për adresimin e tyre. Për më tepër të organizojnë diskutime publike me akterë të ndryshëm për çështje/tema që pritet të adresohen në dialog.

HYRJE

Dialogu në Legjislaturën e shtatë të Kuvendit të Kosovës u karakterizua me zhvillime dinamike. Fillimi i legjislaturës e gjeti procesin e dialogut të pezulluar për shkak të tarifës 100% ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, të vendosur nga e udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj. Reagimi pasues i Serbisë ishte mosgatishmëria për të vazhduar me procesin e dialogut pa heqjen e tarifës. Tarifa u bë një nga shkaqet që qoi tek dorëheqja e kryeministrit Haradinaj, e cila i hapi rrugë zgjedhjeve të reja me 6 tetor 2019. Në fund të vitit u konstituua Kuvendi i ri dhe u zgjodh qeveria e re në krye me Albin Kurtin nga marrëveshja e koalicionit mes Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Një nga premtimet parazgjedhore të kryeministrit të ri Kurti kishte qenë edhe pezullimi i tarifës 100% dhe zëvendësimi i saj me masa të reciprocitetit. Në ndërkohë para formimit të qeverisë së re në dialog po ndodhnin disa zhvillime të reja me përfshirjen më aktive të SHBA-ve gjatë administratës Trump, përmes emisarit special Richard Grenell (në atë kohë Ambasador i SHBA-ve në Gjermani). Ky i fundit kishte arritur që të rikthente palën serbe në tavolinë me tarifën 100% ende në fuqi kur ishin nënshkruar disa marrëveshje me natyrë ekonomike në mes palëve në Berlin. Gjithsesi, kushtëzimi i Serbisë për rikthim në dialog me të gjitha masat, në fillim tarifa dhe tashmë masat e reciprocitetit, vunë nën presion të madh Qeverinë e Kosovës. Si rezultat i takimeve intensive nën ndërmjetësimin e Grenell, në janar të vitit 2020 Kosova dhe Serbia nënshkruan tri letra të qëllimit, për linjën ajrore, hekurudhore dhe autostradat.

Krijimi i Qeverisë Kurti në mars 2020 pasoi, ashtu siç ishte paralajmëruar, me pezullimin e tarifës 100% dhe zëvendësimin gradual me masa të reciprocitetit. Ky vendim u prit ashpër nga ana e Serbisë e cila kërkonte pezullimin e të gjitha masave si parakusht për vazhdimin e dialogut. Kjo pasoi me presion ndaj Kosovës nga ana e ndërmjetësve të dialogut BE-së dhe SHBA-ve, të cilat po ashtu kërkonin nga qeveria pezullimin e të gjitha masave për t'i hapur rrugë vazhdimin të dialogut. Refuzimi i kryeministrit Kurti për të tërhequr

vendimin për reciprocitet qoi tek përplasja mes partnerin e koalicionit LDK-në e cila nuk favorizonte masat e reciprocitetit që sipas tyre po rrezikonin marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë.

Në ndërkohë, Kosova kishte marrë ftesë që të merrte pjesë edhe në një takim në Shtëpinë e Bardhë ku paralajmërohej arritja e një marrëveshje ekonomike mes Kosovës dhe Serbisë. Ftesa për një takim të tillë shihej nga kryeministri Kurti si takim për përmbylljen e një marrëveshje finale me Serbinë që sipas tij mund të përfshinte edhe shkëmbimin e territoreve mes dy vendeve. Mospajtimet për tarifën quan deri tek rënia e qeverisë së sapo krijuar me 25 mars 2020, në periudhë të përballjes me pandeminë Covid-19. Pa zgjedhje të reja, Kuvendi zgjodhi qeverinë tjetër në krye me Avdullah Hotin nga marrëveshja e koalicionit mes LDK-së, AAK-së dhe Nismas. Qysh në ditët e para kryeministri Hoti pezulloi masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, duke i hapur kështu rrugën vazhdimin të dialogut.

Nën ndërmjetësimin amerikan Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen për normalizim ekonomik, me 4 shtator në Uashington. Pas kësaj vazhduan diskutimet edhe për elementet e marrëveshjes finale në Bruksel, nën ndërmjetësimin e emisarit të BE-së Miroslav Lajcak. Para dhe pas takimeve të dialogut Kryeministri Hoti raportoi në Kuvend rreth zhvillimeve të dialogut. Mirëpo, raportimet e tij ishin kryesisht sipërfaqësore me informacione të pakta rreth detajeve të takimeve. Edhe gjatë kësaj legjislature dialogu u bë shkas i debateve të ashpra në Kuvend dhe edhe kjo legjislaturë u shpërbë në fund të vitit 2020 pa u arritur një konsensus i gjerë politik për dialogun. Edhe gjatë kësaj periudhe Kuvendit i munguan diskutimet përmbajtësore rreth dialogut dhe kërkesat e mirëfillta për transparencë e llogaridhënie nga ana e deputetëve. Kështu tema e dialogut në seanca dhe komisione parlamentare vazhdoi të jetë peng i kalkulimeve partiake dhe arenë e përplasjeve verbale mes spektrit politik.



1 DIALOGU NË SEANCAT E KUVENDIT

Legjislatura e shtatë e Kuvendit të Kosovës (dhjetor 2019 – janar 2021) është pa dyshim më e shkurta në historinë e parlamentarizmit të Kosovës. Kjo legjislaturë ishte e jashtëzakonshme, edhe për shkak të ndërrimit të dy qeverive brenda të njëjtit sesion, por edhe për shkak se u karakterizua nga një dinamikë e reduktuar e punës për shkak të situatës me pandeminë COVID-19. Këto zhvillime kanë bërë që, përkundër faktit se dialogu ka prodhuar më së shumti polemika gjatë punimeve të Kuvendit – saqë ka shërbyer si një prej arsyeve për rrëzimin e qeverisë Kurti – ato nuk janë reflektuar në trajtim të kësaj çështje në seancat e Kuvendit. Pothuajse të gjitha diskutimet lidhur me dialogun ishin reaktive, në bazë të zhvillimeve të dialogut – të tilla si heqja e taksës, vendosja e reciprocitetit, fillimi i takimeve të grupeve teknike dhe arritja e Marrëveshjes së Uashingtonit – dhe që në vend të ofrimit të zgjidhjeve përmbajtësose, shpërfaqnin përplasjet dhe qëndrimet diametralisht të kundërta mes subjekteve politike, e në veçanti mes pozitës dhe opozitës, ndonëse të tilla përplasje ka pasur edhe mes vet partnerëve të koalicioneve qeverisëse – në të dy qeveritë.

Dialogu si çështje është trajtuar – si pikë e veçantë e rendit të ditës apo vetëm si diskutim – në 27 prej gjithsej 72 seancave të mbajtura, përfshirë vazhdimet e seancave dhe seancat e jashtëzakonshme. Shprehur në përqindje, 38% e të gjitha seancave janë shfrytëzuar nga deputetët për ngritjen e dialogut si temë, apo çështjeve të ndërlidhura me të. Më shumë se gjysma e rasteve, përkatësisht seancave, kur është trajtuar dialogu apo çështjet e ndërlidhura me të, ishin seanca plenare (52%), ndërsa në seanca të jashtëzakonshme dialogu është trajtuar në 11% të seancave. Po ashtu, dialogu është trajtuar edhe në nëntë vazhdime të seancave, të cilat janë mbajtur të gjitha në sesionin vjeshtor (33%). Dialogu është diskutuar edhe gjatë një seance të veçantë, e mbajtur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit dhe Nderimit të Viktimave të Krimeve të Gjenocidit, si dhe Parandalimi i këtij krimi.

Si pikë e rendit të ditës, dialogu ka qenë pjesë e mbi 60% të të gjitha seancave, përkatësisht në 18 nga 27 seancat ku është trajtuar dialogu. Si çështje, dialogu është diskutuar dukshëm më shumë pas rënies së Qeverisë 'Kurti', respektivisht zgjedhjes së Qeverisë 'Hoti'. Kjo në fakt është e ndërlidhur edhe me qasjen e qeverisë së re, e udhëhequr nga Avdullah Hoti, e cila qysh në ditët e para kishte marrë vendim për heqjen e reciprocitetit ndaj Serbisë, duke i hapur rrugë kështu rifillimit të dialogut. E një qasje e tillë, ishte kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje si parti opozitare, duke bërë që në një pjesë prej seancave të mbajtura, dialogu apo temat e ndërlidhura me të, të jenë çështje të diskutimeve dhe përplasjeve.

Ndërsa, janë gjithsej 27 pika të veçanta ku dialogu është trajtuar, pjesa dërrmuese e të cilave në sesionin vjeshtor. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i arritjes së Marrëveshjes së Uashingtonit në shtator të vitit të kaluar, e që si ngjarje kishte prodhuar reagime të shumta në mesin e opozitës, në veçanti Lëvizjes Vetëvendosje, subjekt ky i cili kishte thirrur një numër të madh të raportimeve dhe kishte hedhur në votim propozim-rezoluta të caktuara. Ndërsa, në pjesën e parë të vitit, respektivisht gjatë sesionit pranveror, dialogu ishte trajtuar në vetëm pesë seanca, duke përfshirë edhe dy seancat – njëra për formimin, e tjetra për rrëzimin e qeverisë 'Kurti'. Në këtë sesion, përtej dy diskutimeve gjatë formimit dhe rrëzimit të Qeverisë, në tri raste kur dialogu ishte pikë e rendit të ditës, dy prej tyre ishin debate parlamentare, që kishin trajtuar çështjen e paralajmërimit të heqjes së tarifës 100% nga ish-kryeministri Kurti, ndërsa tjetri lidhur me qasjen e Kosovës në raport me këshillat dhe udhëzimet e SHBA-ve, përkatësisht marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. Kurse, gjatë seancës kur ishte votuar mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë, dialogu ishte shndërruar në temën kryesore, përfshirë akuzat e ndërsjella të shkëmbyer mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe subjekteve tjera, për shkak të, sipas LVV-së, ndikimit të çështjes së dialogut në rrëzimin e Qeverisë së udhëhequr nga ta.



Dialogu si çështje është trajtuar – si pikë e veçantë e rendit të ditës apo vetëm si diskutim – në

27 prej gjithsej



72 Seancave të mbajtura,

përfshirë vazhdimet e seancave dhe seancat e jashtëzakonshme.

Parë nga aspekti përmbajtësor i diskutimeve, vërehet se ngritja e dialogut dhe temave tjera të ndërlydhura më të, ka ardhur kryesisht si rezultat i zhvillimeve politike në këtë proces, si në kuptim të procesit të zhvilluar në Bruksel, ashtu edhe në atë në Uashington.

Sa i përket trajtimit të dialogut vetëm si diskutim gjatë seancave, në nëntë prej tyre, diskutimet kishin ndodhur lidhur me fatin e personave të zhdukur, problemet me kthim në prona të banorëve shqiptarë në pjesën veriore të vendit, raportin e punës 100 ditëshe të Qeverisë 'Hoti', reciprocitetit me Serbinë në raport me situatën me pandeminë, si dhe zgjedhjeve, respektivisht rrëzimit të Qeverisë.

Krahasuar me legjislaturën e gjashtë, përkatësisht vitin 2018, vërehet një trend në rënie i trajtimit të dialogut në seancat e Kuvendit, për më shumë se 10% të seancave. Madje, kjo rënie është shënuar pikërisht në periudhën kur ka pasur dy procese të dialogut, një nën ndërmjetësimin e BE-së dhe një tjetër nën atë të SHBA-ve, krahasuar me vitin 2018 kur nuk ka pasur formalisht proces të dialogut. Sigurisht, situata me pandeminë, krizat politike si dhe përplasjet mes subjekteve politike kanë qenë ndër arsyt kryesore për një rënie të tillë të fokusit të Kuvendit ndaj këtij procesi, në kuptim të trajtimit të tij gjatë seancave.

Në kuadër të të gjitha seancave ku është trajtuar dialogu, shumica e tyre kanë qenë si rezultat i interpelancave apo debateve parlamentare të thirrura për to, me fokus në çerekmuajorin e fundit të vitit 2020, kur janë thirrur deri në katër interpelanca në të njëjtën seancë, për të trajtuar pika të ndryshme të Marrëveshjes së Uashingtonit. Kryesisht si rezultat i një qasje të tillë të opozitës, ka bërë që ekzekutivi në shumë raste të sillet me arrogancë dhe shpërfillje ndaj kërkesave opozitare për raportim, transparencë dhe llogaridhënie. Në disa raste, kryeministri Hoti, apo edhe anëtarët tjerë të kabinetit qeveritar, kishin refuzuar raportimin në Kuvend, respektivisht

komisione parlamentare lidhur me çështje të dialogut. Për shembull, përkundër ftesës, më 7 tetor, kryeministri Hoti dhe ministrja Haradinaj, nuk kishin raportuar para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me çështjen e personave të pagjetur në kuadër të dialogut me Serbinë. Ndërsa, në disa prej seancave kur ishin thirrur një numër i interpelancave për çështjen e dialogut, kryeministri Hoti nuk ishte përgjigjur në të gjitha çështjet e ngritura nga deputetët, sidomos ata të opozitës, dhe në fakt në disa raste edhe kishte lëshuar mbledhjen e Kuvendit¹.

Po ashtu, në mungesë të votave, opozita kishte dështuar që të shtyjë përpara miratimin e rezolutave të dala nga interpelancat apo debatet parlamentare. Gjegjësisht, në një prej seancave të fundit, gjashtë projekt-rezoluta të hedhura në votim nuk kishin mundur të miratohen në mungesë të kuorumit për vendimmarrje.

Rezolutat lidhur me dialogun apo çështjet që preken nga ky proces, ishin ndër pikat më polarizuese politike mes opozitës, përkatësisht LVV-së dhe subjekteve tjera. Sidoqoftë, **rezoluta e vetme rreth dialogut e miratuar ishte pikërisht ajo e sponsorizuar nga LVV dhe LDK, kur të njëjtat ishin në koalicion qeverisës.** Në bazë të kësaj rezolute, e miratuar më 15 mars të vitit 2020, Kuvendi kishte shprehur qëndrimin politik se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për bisedime politike me Serbinë, që do të rezultojnë me njohje reciproke. Kuvendi, përmes rezolutës, kishte përçuar mesazh edhe me ruajtjen e sovranitetit shtetëror, integritetit territorial dhe karakterit unitar të shtetit, dhe kishte ritheksuar se askush nuk ka të drejtë të negociojë mbi këto çështje. Kuvendi gjithashtu kishte kërkuar që procesi i dialogut të udhëhiqet nga Qeveria e vendit, sipas përcaktimeve kushtetuese dhe aktgjykimit përkatës të Gjykatës Kushtetuese.

¹ Për më shumë, shih lajmin: <https://insajderi.org/kryeministri-injoron-deputetet-e-vv-se-largohet-nga-interpelanca/>



2 MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NË SEANCA

Përkundër kuadrin relativisht të konsoliduar që ofrohet nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për mbikëqyrjen parlamentare, gjatë këtij sesioni deputetët nuk kanë ushtruar të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbikëqyrje. Përgjithësisht, forma më e përdorur për mbajtjen e ekzekutivit llogaridhënës në raport me dialogun ishin interpelancat, debatet parlamentare, raportimet e kryeministrit dhe pyetjet parlamentare.

2.1 Interpelancat

Përgjatë vitit 2020, respektivisht legjislaturës së shtatë të Kuvendit, janë thirrur dhe mbajtur gjashtë interpelanca parlamentare. Të gjitha këto interpelanca janë thirrur dhe mbajtur në sesionin vjeshtor, dhe i janë drejtuar kryeministrit Avdullah Hoti. Si numër, kjo përbën më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të interpelancave të mbajtura (11) gjatë vitit 2020. **Pesë nga interpelancat parlamentare lidhur me dialogun janë thirrur nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa një interpelancë nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Nga këto interpelanca janë propozuar rezoluta, të cilat nuk kanë arritur të miratohen, në mungesë të kuorumit në vendimmarrje.**

Interpelanca e parë, e thirrur nga LVV, e mbajtur në qershor të vitit 2020, ishte thirrur lidhur me vendimin e kryeministrit Hoti për heqjen e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë. Ky në fakt ishte ndër vendimet e para të Qeverisë 'Hoti', që si element, përbënte pikën më polarizuese në atë periudhë mes dy ish-partnerëve të koalicionit qeverisës. Gjatë kësaj interpelance, ishin shpërfaqur mospajtime të theksuara, veçanërisht

mes LDK dhe LVV, me këta të fundit që lëshuan akuza mbi ekzekutivin se kanë qasje të gabuar në raport me dialogun.

Interpelanca tjetër parlamentare ishte mbajtur pas gati katër muajsh, pasi që në Bruksel kishin filluar takimet e para të grupeve të ekspertëve të dy palëve, ku ishin diskutuar temat e personave të pagjetur dhe bashkëpunimi ekonomik, ndërsa ishin paralajmëruar edhe tema si pretendimet pronësore dhe çështjet financiare. Interpelanca ishte iniciuar me kërkesë të PDK-së, lidhur me përgjegjësitë në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel lidhur me punën e grupeve teknike, të cilat udhëhiqeshin nga Koordinatori Shtetëror, Skender Hyseni.

Gjatë muajit tetor, por edhe paraprakisht, ishte ngritur shqetësimi për rifillimin e dialogut në nivelin teknik, që kishte bërë që sërish të ketë përplasje mes pozitës dhe opozitës. Tri interpelanca ishin mbajtur brenda së njëjtës ditë, më 21 tetor, të thirrura nga LVV lidhur me marrëveshjen e arritur në Uashington. Interpelancat trajtuan pika të caktuara të marrëveshjes, përfshirë pezullimin njëvjeçar të aplikimit për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, mini-Schengenin ballkanik, si dhe lidhur me qëndrimin e kryeministrit për zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Krahasuar me vitin 2018, kur Kuvendi kishte zhvilluar punimet në të dy sesionet, vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të interpelancave të thirrura lidhur me dialogun apo çështjet e ndërlidhura me të. Gjatë atij viti ishte thirrur vetëm një interpelancë. Ndërsa, në sesionin pranveror të vitit 2019, nuk ishte thirrur asnjë e tillë.



5



nga interpelancat parlamentare lidhur me dialogun janë thirrur nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje,

1



interpelancë nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Nga këto interpelanca janë propozuar rezoluta, të cilat nuk kanë arritur të miratohen, në mungesë të kuorumit në vendimarrje.

2.2 Debatet parlamentare

Një formë tjetër mjaft e ushtruar e mbikëqyrjes nga deputetët gjatë vitit 2020 ishin debatet parlamentare lidhur me dialogun apo çështjet e ndërlidhura me të. Debatet parlamentare janë formë e ushtrimit të mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, duke u ofruar të gjithë deputetëve më shumë hapësirë kohore që të paraqesin pikëpamjet e tyre dhe të parashtrojnë pyetje apo të ngrisin tema lidhur me çështje të caktuara. Për dallim nga format tjera, si interpelancat, debatet parlamentare nuk kanë kohëzgjatje të kufizuara, ndërsa deputetëve u ofrohet minutazhë e njëjtë sikur në diskutimet tjera të rëndomta. Në anën tjetër, debatet nuk janë të targetuara domosdo ndaj një anëtari të ekzekutivit, por mund të përfshijë në diskutime numër më të madh të pjesëmarrësve.

Gjithsej, janë mbajtur pesë debate parlamentare, prej të cilave tri në sesionin vjeshtor dhe dy në atë pranveror. Në fakt, vetëm një muaj pas formimit të qeverisë, më 2 mars ishte thirrur seancë e jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me paralajmërimin e ish-kryeministrit Kurti për heqjen e tarifës 100%. Kërkesa për debat ishte parashtruar nga 41 deputetë, ndërsa si propozues ishte grupi parlamentar i AAK-së. Ky debat, ngjashëm sikur pjesa dërrmuese e diskutimeve lidhur me dialogun, kishte prodhuar përplasje mes pozitës dhe opozitës. Disa ditë pas, ishte thirrur edhe një seancë e jashtëzakonshme për debat parlamentar, sërish ndaj ish-kryeministrit Kurti në lidhje me rrezikimin e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të.

Pothuajse menjëherë pas ndryshimit të Qeverisë, në seancën e 23 qershorit, kur ishte mbajtur interpelanca e parë ndaj kryeministrit Hoti dhe raportimi i tij për dialogun, ishte zhvilluar edhe debat parlamentar mbi këtë proces. Dy debatet tjera parlamentare ishin mbajtur në fillim të muajit nëntor 2020, përkatësisht më 2 dhe 3 nëntor. Debati i parë i këtij sesioni ishte mbajtur lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës, përkatësisht me pengesat që u bëhen atyre për t'u kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës. Ndërsa, të nesërmen ishte mbajtur debati tjetër parlamentar, lidhur me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që të mbaj të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidale në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur. Gjatë të dyja këtyre debateve parlamentare ishte kërkuar ndryshim i qasjes së Kosovës në raport me temat përkatëse, por edhe ishin shkëmbyer akuza mes ekzekutivit dhe disa deputetëve të opozitës.

Krahasuar me vitet paraprake, edhe debatet parlamentare kanë shënuar një ngritje sa i përket numrit të tyre, meqenëse gjatë vitit 2018 ishin mbajtur tri debate parlamentare, kurse në sesionin pranveror të vitit 2019 – vetëm një debat parlamentar. Pra, vetëm gjatë vitit 2020 janë mbajtur më shumë debate parlamentare lidhur me dialogun apo temat e ndërlidhura me të, sesa gjatë dy viteve paraprake, 2019 dhe 2020.





2.3 Raportimet dhe informimet e kryeministrit

Gjatë legjislaturës së shtatë të Kuvendit, veçanërisht pas ndërimit të qeverisë, përkatësisht pas formimit të Qeverisë 'Hoti' në kuadër të seancave të mbajtura ka pasur raportime dhe informime të kryeministrit lidhur me ecurinë, progresin dhe zhvillimet në kuadër të procesit të dialogut. Që nga zgjedhja e Qeverisë 'Hoti' në qershor të vitit 2020, gjithsej janë katër pika të rendit të ditës ku kryeministri ka raportuar dhe informuar deputetët mbi zhvillimet lidhur me dialogun Kosovë-Serbi. Fillimisht, më 23 qershor, me vendim të Kryesisë, Kuvendi kishte ftuar në raportim kryeministrin Hoti lidhur me këtë proces, si një nga pikat e rendit të asaj dite. Gjatë këtij raportimi, kryeministri kishte bërë të ditur parimet e qeverisë së tij lidhur me procesin e dialogut dhe objektivat e këtij procesi. Në atë seancë, kryeministri i kishte propozuar Kuvendit që të formonte një komision ad-hoc parlamentar për mbikëqyrjen e procesit të dialogut, nën udhëheqjen e opozitës, propozim ky i cili nuk kishte gjetur përkrahjen e forcave politike. Raportimi i radhës i kryeministrit Hoti kishte ndodhur më 17 shtator, me kërkesë të këtij të fundit që t'i informojë deputetët me zhvillimet e procesit të dialogut, që ndërlihdeshin me marrëveshjen e arritur në Uashington më 4 shtator. Në këtë seancë, kryeministri Hoti kishte ritheksuar edhe një herë parimet e procesit dhe objektivat e tij, si dhe kishte elaboruar përmbajtjen e pikave të marrëveshjes në fjalë. Po ashtu, kryeministri kishte bërë të ditur që pas arritjes së asaj marrëveshje, është zhvilluar takim i nivelit të lartë me palën serbe edhe në Bruksel, ku janë hapur temat e obligimeve financiare dhe tema e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Raportimi tjetër i kryeministrit Hoti lidhur me dialogun, kishte ndodhur gjatë raportit për punën 100 ditëshe të qeverisë së tij. Gjatë këtyre diskutimeve, deputetët kanë ngritur çështje si përbërja e delegacioneve dialoguese, platformës së Kosovës në kuadër të dialogut dhe të ngjashme, duke shpërfaqur përplasjet dhe mos pajtimet e shumta mbi këtë proces.

Sidoqoftë, vlen të përmendet që këto raportime dhe informime janë cilësuar si jo përmbajtësore, sidomos nga opozita, pasi që në to nuk janë ofruar informacione dhe përgjigje të detajuara lidhur me pyetjet e parashtruara apo çështjet e ngritura nga deputetët².

2.4 Pyetjet parlamentare

Duke qenë një mekanizmi më i zakonshëm i mbikëqyrjes, pyetjet parlamentare kanë vazhduar të jetë formë e ushtruar nga deputetët edhe gjatë vitit 2020. **Deputetët kanë parashtruar gjithsej 187 pyetje parlamentare, prej të cilave përgjigje është dhënë në rreth 80% të tyre. Sidoqoftë, nga numri i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare të parashtruara, vetëm shtatë prej tyre, apo më pak se 4% ishin lidhur me dialogun.** Të gjitha pyetjet ishin parashtruar gjatë sesionit vjesh-tor dhe të njëjtat i ishin drejtuar kryeministrit Hoti. Gjashtë prej këtyre pyetjeve ishin parashtruar nga dy deputete të LVV-së, Fitore Pacolli-Dalipi (4) dhe Mimoza Kusari-Lila (2), ndërsa një pyetje ishte parashtruar nga Ariana Musliu-Shoshi nga PDK. Nga shtatë pyetjet parlamentare, kryeministri Hoti apo kabineti qeveritar nuk kanë ofruar përgjigje në dy prej tyre, të parashtruara nga deputetja Fitore Pacolli-Dalipi.

Sa i përket përmbajtjeve të pyetjeve parlamentare të parashtruara lidhur me dialogun, ato kanë ndjekur përgjithësisht zhvillimet në kuadër të procesit të dialogut apo temave të ndërlihdura me të. Pyetjet e parashtruara kanë pasur të bëjnë me varrezat masive në Serbi me trupa të shqiptarëve, mini-Schengenit, mos aplikimin e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare për një vit, idenë e shkëmbimit të territoreve, takimin e Uashingtonit, si dhe rastin e supozuar të humbjes së çantës me dokumente të klasifikuara të një prej anëtarëve të delegacionit negociues të Kosovës në Bruksel.

Krahasuar me vitet paraprake, respektivisht sesionin pranveror të vitit 2019, dhe tërë vitin 2018, sërish vërehet një tendencë e deputetëve për mos ushtrimin e këtij mekanizmi mbikëqyrës ndaj qeverisë, meqenëse numri i pyetjeve lidhur me dialogun, përkatësisht përqindja e pyetjeve parlamentare në raport me numrin e përgjithshëm të pyetjeve, mbetet përafërsisht i ngjashëm.

² Për më shumë, shih transkriptin e mbledhjeve plenare të Kuvendit, të mbajtura më 17, 18, 21, 25, 28 shtator dhe 8, 16 tetor 2020. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2020_09_17_ts_Seanca_9XaqKbhRRR.pdf



dhe Selanikut. Më tutje ministri kishte ofruar sqarime edhe lidhur me mundësinë e njohjes nga shteti i Xhamajkës dhe paralajmërimet për çnjohje nga Sierra Leone. Pas këtij raportimi do të shkonin disa muaj derisa komisioni do të thërriste një raportim tjetër rreth dialogut. Kjo për arsye të shkarkimit të Qeverisë Kurti me 25 mars 2020.

Lidhur me çështjen e dialogut komisioni për punë të jashtme diskutoi pas zgjedhjes së qeverisë së re Hoti. Me 17 qershor 2020, ky komision vendosi për të ftuar në raportim Kryeministrin Hoti lidhur me zotimin e Qeverisë për pezullimin e angazhimit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe vizitën e tij në Uashington para udhëtimit të tij në SHBA.⁴ Mirëpo i njëjti nuk iu përgjigj ftesës së komisionit dhe raportoi lidhur me këto çështje në seancë të Kuvendit.

Komisioni ftoi në raportim edhe ministren e re të jashtme të emëruar në qeverinë Hoti, znj. Meliza Haradinaj me 28 korrik 2020.⁵ Kjo mbledhje u karakterizua me debate të ashpra mes ministres dhe antarëve të opozitës në këtë komision pikërisht lidhur me temën e dialogut. Këta të fundit kërkuar konfirmim nga ministrja se a ishte pajtuar qeveria për pezullimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Ministrja nuk i ishte përgjigjur kësaj pyetje, por ky shqetësim i ngritur nga anëtarët e komisionit u konfirmua dy muaj më vonë me 4 shtator në takimin e Uashingtonit, ku Kosova u zotua për moratorium një vjeçar të aplikimit në organizata.⁶

Komisioni për punë të jashtme ngriti çështjen e dialogut për herë të fundit në mbledhjen e mbajtur me 8 dhjetor 2020. Në këtë mbledhje anëtarët e komisionit mbajtën takim me Komisionin për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, gjatë të cilit u ngrit edhe çështja e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Anëtarët e komisionit kërkuar nga delegacioni i Shqipërisë, i udhëhequr nga kryetarja znj. Mimi Kodheli, mbështetje më të madhe për çështjen e Kosovës, përfshirë edhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Ndërkaq, edhe znj. Kodheli kishte kërkuar koordinim më të madh mes dy shteteve duke theksuar faktin që Shqipëria sikurse edhe Kosova nuk kanë bërë mjaftueshëm për zbardhjen e gjenocidit serb. Anëtarët e komisionit gjithashtu kërkuar që Kuvendi i Shqipërisë të miratojë një rezolutë nëpërmjet së cilës dënohet gjenocidi i shtetit serb ndaj qytetarëve shqiptarë.

3.2 Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ishte po ashtu një nga komisionet që ka diskutuar më së shumti lidhur me çështjet e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi. Gjatë legjislaturës së shtatë ky komision ka ngritur temën e dialogut në 10 nga 24 mbledhjet e mbajtura. Fokus i diskutimeve ishin temat si gjendja në veri të vendit dhe çështja e të pagjeturve.

Në mbledhjen e 11 marsit 2020, komisioni ngriti çështjen e gjyqësorit në veri të vendit, gjatë raportimit të ish avokatit të popullit, z. Hilmi Jashari.⁷ Avokati u pyet për gjendjen e gjyqësorit në veri të vendit, për të cilin u tha se është një gjendje jo e mirë, e cila ndikon në jetën e qytetarëve të Mitrovicës. Gjendja në veri u ngrit edhe në tri mbledhje të radhës të komisionit, me 13 maj⁸ dhe 19 maj 2020⁹, konkretisht lidhur me ndarjen e mjeteve në vlerë prej 10 milionë euro nga ana e Qeverisë së Kosovës për pagesën e shpenzimit të rrymës në veri të Kosovës. Që nga përfundimi i luftës qytetarët e asaj pjese nuk paguajnë shpenzimet e rrymës elektrike dhe faturimi u ishte shpërndarë qytetarëve tjerë të vendit. Për të diskutuar lidhur me këtë çështje, komisioni kishte ftuar sërish avokatin e popullit z. Hilmi Jashari dhe përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike (KOSTT). Anëtarët e komisionit kërkuar sqarim juridik lidhur me atë nëse ky vendim ishte shkelje ligjore nga ana e Qeverisë, duke qenë se vendimi në fjalë përbënte diskriminim të qytetarëve, duke i shkelur të drejtat e tyre. Avokati i Popullit, kishte sqaruar para anëtarëve se vendimi i shpërndarjes së faturimit të energjisë të shpenzuar nga qytetarët e pjesës veriore tek qytetarët e pjesëve tjera të Kosovës, dukuri kjo tashmë disa vjeçare, përbënte shkelje të rëndë të ligjit. Ndërsa, përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it, informuan komisionin se mjetet e ndara në vlerë prej 10 milionë euro nuk ishin mjete

4 Shih këtë mbledhje në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-pune-te-jashtme-25216/>

5 Shih këtë mbledhje në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/ne-komisionin-per-pune-te-jashtme-dhe-diaspor-25471/>

6 Shih zotimet e Uashingtonit në, http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/MarreveshjaveUashingtonitmesKosovesdheSerbise_4shtator2020_n6YHEEF9UL.pdf

7 Shih këtë mbledhje në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-24714/>

8 Shih këtë mbledhje në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-24936/>

9 Shih këtë mbledhje në, <http://www.votaimo.org/Public/Commissions/ViewCommission/32>

Nga gjithsej

263



mbledhje të komisioneve të mbajtura gjatë kësaj legjislature,

tema e dialogut u ngrit në 38 prej tyre apo



mbulesë për shpenzimet e energjisë elektrike në veri, por si një garant për t'u kçuçur në Rrjetin Evropian të Sistemit të Operatorëve. Në anën tjetër anëtarët e komisionit shfaqën shqetësimet e tyre sa u përket praktikave diskriminuuese ndaj qytetarëve, duke shikuar mundësitë e rimbursimit të qytetarëve për aq kohë sa kanë paguar për 5 % më shumë në faturat e tyre, për të mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike në veri të Kosovës. Po ashtu, anëtarët e komisionit konstatuan se me rastin e faturimit prej 5 % të energjisë elektrike qytetarëve të Kosovës u është bërë shkelje e të drejtave të njeriut, duke kërkuar llogari nga institucionet përkatëse.

Në vazhdim të diskutimeve rreth veriut, komisioni realizoi edhe një vizitë në terren me 22 korrik 2020, në disa lokalitete në këtë pjesë të vendit.¹⁰ Fokus i të gjitha takimeve të anëtarëve të Komisionit me përfaqësues të kësaj pjese ishte shkelja e vazhdueshme e të drejtës elementare të banorëve shqiptarë të atyre lokaliteteve, për tu kthyer dhe për të jetuar në pronat dhe në shtëpitë e tyre. Në këto takime banorët shprehën shqetësimet e tyre lidhur me privimin nga e drejta e marrjes së lejeve për renovim të shtëpive të tyre, ndërkohë që pjesëtarët e komunitetit serb po merrnin leje. Anëtarët e Komisionit vizituan edhe të ashtuquajturën lagjen Lugina e Diellit, lagje ku Serbia ka investuar në ndërtimin e një fshati të ri, në lokalitetin ku nuk ka pasur asnjë familje të komunitetit serb. Në fund anëtarët e Komisionit u zotuan se do të bashkëpunojnë me të gjitha hallkat e pushtetit qendror dhe lokal, që kjo gjendje të ndryshojë dhe tu jepet fund shkeljeve

sistematike të të drejtave të njeriut në këtë pjesë të vendit. Lidhur me këtë anëtarët e komisionit ftuan nënkryetarin e Komunitetit të Mitrovicës Veriore, Aleksandër Spiriq, mirëpo i njëjti nuk iu përgjigj ftesës. Deputetët mbajtën edhe një debat parlamentar dhe iniciuan një rezolutë, mirëpo për të cilën nuk pati kuorum të mjaftueshëm për miratim.

Një nga temat që shkaktoi më së shumti debat në këtë komision ishte tema e të pagjeturve. Lidhur me këtë çështje komisioni kishte ftuar për raportim zëvendës kryeministrin Driton Selmanaj, në të cilën kërkesë qeveria ishte përgjigjur negativisht, duke e parë të panevojshëm një raportim të tillë.¹¹ Komisioni vendosi t'i ftojë në raportim kryeministrin z. Avdullah Hoti, ministrin e Drejtësisë z. Selim Selimi dhe ministrin e Punëve të Jashtme znj. Meliza Haradinaj. Kjo e fundit nuk iu përgjigj ftesës së Komisionit, ndërsa kryeministri dhe ministri Selimi raportuan në mbledhjet e ardhshme. Kryeministri raportoi me 9 dhjetor, mirëpo kishte kërkuar që raportimi të mbahet pa prezencë të mediave dhe publikut, për arsye që sipas tij informacionet rreth kësaj teme ishin të natyrës së brendshme.¹² Ndërsa ministri Selimi raportoi në mbledhjen e datës 7 tetor 2020, në të cilën i informoi anëtarët e komisionit lidhur me përpjekjet e Qeverisë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve dhe rezultatet nga takimet e dialogut me Serbinë.¹³ Ai tha se çështja e të pagjeturve është prioritet i qeverisë dhe se është arritur pajtueshmëri në disa parime në kuadër të dialogut me Serbinë. Sipas tij, nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare pa u zgjidhur çështja e të pagjeturve. Komisioni ngriti sërish këtë temë edhe në mbledhjen e

10 Shih detajet e vizitës në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/sherbimet/te-gjitha-lajmet/?DateFrom=07%2F20%2F2020&DateTo=07%2F23%2F2020&pagination=1>

11 Shih më shumë në, <https://albanews.org/2020/10/13/dokumenti-qe-konfirmon-se-driton-selmanaj-e-kishte-cilesuar-te-konsumuar-dhe-ezauruar-temen-e-te-zhdukurve/>

12 Shih <https://www.koha.net/arberi/244825/hoti-raporton-per-ceshtjen-e-te-pagjeturve-komisioni-mbahet-i-mbyllur-per-mediat/>

13 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-25888/>

20 nëntorit pas gërmimeve në disa varreza masive në Serbi.¹⁴ Në këtë mbledhje komisioni shqyrtoi edhe projekt-rezolutën nga debati parlamentar, lidhur me pengesat e banorëve shqiptarë në komunat veriore, për kthim në pronat e tyre dhe renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës.¹⁵

Anëtarët e këtij komisioni së bashku me përfaqësues nga komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur realizoi edhe një vizitë në Veri të vendit, në ditën ndërkombëtare të përkujtimit dhe nderimit të viktimave të krimeve të gjenocidit.¹⁶ Me këtë rast ata vizituan varrezat myslimane në Veri ku u njoftuan se nga pas lufta në këto varreza janë gjetur dhe zhvarrosur mbetjet mortore të më shumë se 70 viktimave. U tha se në këtë lokacion është punuar me prioritet, përderisa punimet do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, ngase dyshohet edhe për trupa të tjerë. Nga atje, anëtarët e komisionit dhe anëtarët qeveritar kërkuan që bashkësia ndërkombëtare të vazhdojë presionin mbi palën serbe, në mënyrë që kjo e fundit të ofrojë me shumë bashkëpunim dhe informacione lidhur me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë. Po ashtu u kërkua që institucionet e Kosovës të kenë një vendosmëri më të madhe që personat e pagjetur dhe familjet e tyre të jenë prioriteti i të gjitha aktiviteteve por, edhe kushti i çfarëdo bisedimeve që zhvillohen me Serbinë.

Hera e fundit kur ky komision ngriti çështjen e të pagjeturve ishte në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2020, në takimin që mbajti me Avokatin e ri të Popullit z. Naim Qelaj dhe përfaqësuesit e fshatrave Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël.¹⁷ Përfaqësuesit e këtyre dy fshatrave shfaqën shqetësimet e tyre në lidhje me të pagjeturit, si dhe shprehën zhgënjimin për uljen e dënimit të njerit nga të gjykuarit për këtë rast, gjithnjë duke kërkuar drejtësi nga institucionet gjegjëse. Ndërsa, Avokati i Popullit, z. Qelaj, u zotua për angazhim të tij për drejtësi në suaza të fushëveprimtarisë së institucionit që ai përfaqëson.

3.3 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal është një nga komisionet që diskutoi në masë të madhe për temat e ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi. Gjatë kësaj periudhe ky komision ngriti çështjen e dialogut në nëntë nga 28 mbledhjet e mbajtura, me fokus në temat si marrëveshja e energjisë, marrëveshja e telekomit dhe raportet tregtare me Serbinë.

Qysh në fillim të vitit 2020, konkretisht me 25 shkurt komisioni vendosi për përfshirje të monitorimit të procesit të dialogut në Planin e punës.¹⁸ Një nga temat e para të ndërlidhura me dialogun që ky komision ka diskutuar ishte çështja e energjisë e lidhur me marrëveshjen e Brukselit për energji. Në mbledhjen e 3 marsit 2020 ku ishte i ftuar përfaqësuesi i Komitetit për Energji, Janez Kopac, paraqiti si sfidë faktin që Kosova ende nuk ka arritur që t'i implementojë dhe t'i vë në praktikë të gjitha detyrimet që dalin nga rregulloret dhe direktivat e Komunitetit për Energji.¹⁹ Sipas tij, problemi i madh vjen për shkak të moszgjdhjes së mosmarrëveshjes në mes të KOSTT-it dhe rrejtit të transmisionit të Serbisë, e cila i bllokon shumë reforma, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Serbi dhe në tërë rajonin.

Tema e energjisë u diskutua edhe në mbledhjen e komisionit të datës 26 maj²⁰ dhe 9 qershor 2020²¹ me ç'rast u ngriti çështja e energjisë elektrike në veri pas krijimit të KOSTT-it si zonë transmetimi e veçantë. Në këtë drejtim komisioni ngriti çështjen e zgjedhjes së bordit të KOSTT-it dhe mundësinë e apelit nga Serbia të marrëveshjes së Kosovës me ENTSO-E.

Një çështje e cila shkaktoi debat në këtë komision ishte mundësia e blerjes së operatorit IPKO nga kompania serbe Telekom Serbia. Në dy mbledhje të mbajtura me 26 qershor²² dhe 21 korrik 2020²³, anëtarët e komisionit shprehën shqetësimin e tyre për ndikimin e blerjes potenciale të kësaj kompanie

14

15 Po aty.

16 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/komisioni-pr-t-drejtat-e-njeriut-barazi-gjino-26361/>

17 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-26385/>

18 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/komisioni-per-ekonomi-punesim-tregti-industri-24564/>

19 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-24615/>

20 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-25038/>

21 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/komisioni-per-ekonomi-punesim-tregti-industri-25134/>

22 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-25318/>

23 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-25417/>

nga Serbia, në cenimin e sigurisë së brendshme të Kosovës. Për tu informuar më tutje rreth kësaj mundësie komisioni ftoi në raportim përfaqësuesit e ARKEP-it dhe kryeshefen e Telekomit të Kosovës.

Komisioni diskutoi edhe për çështjen e marrëveshjes së telekomit me 22 shtator.²⁴ Më konkretisht përmbushjen e kodit shtetëror +383, i cili po ngec në implementim nga operatori VALA, ndërsa nga operatori IPKO implementimi ka shkuar në suaza të rregullta.

Çështja e fundit e ndërlidhur me dialogun e diskutuar nga ky komisioni ishin marrëdhëniet tregtare të Kosovës me rajonin, ku ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z.Vesel Krasniqi, i ftuar me për të raportuar në mbledhjen e 28 tetorit, i kishte informuar anëtarët e komisionit për problemet me të cilat janë duke u ballafaquar prodhuesit dhe transportuesit vendorë në CEFTA.²⁵ Sipas tij problematikë për mos respektimin e marrëveshjes së CEFTA-s del të jetë mbishkrimi UNMIK, në vend të Republikës së Kosovës, dhe barrierat doganore me Serbinë. Ai i kishte njoftuar anëtarët e komisionit se shqetësimet për këto sfida i kanë adresuar me shkresë zyrtare në zyrën e Bashkimit Evropian, në Ambasadën amerikane në Kosovë, Zyrën e kryeministrit si dhe në CEFTA.

3.4 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Gjatë legjislaturës që po e lëmë pas, tema e dialogut Kosovë-Serbi u ngrit edhe në komisionin për mbikëqyrjen e financave publike. Ky komision diskutoi rreth kësaj teme në tri nga 21 mbledhjet e mbajtura. Konkretisht objekt i këtyre diskutimeve ishin tema e faturimit të shpenzimeve të ujit në veri, integrimi i pjesëtarëve serb në institucionet e Kosovës dhe çështja e pronave.

Në mbledhjen e 26 qershorit 2020, ky komision diskutoi lidhur me shfrytëzimin e ujit në veri, në kuadër të pikës së rendit të ditës për shqyrtimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për vitin 2019.²⁶ Anëtarët e komisionit theksuan gjetje e auditorit për një pagesë që MAPL kishte bërë për kompaninë

rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica", i cili kishte vërejtur se ishin paguar faturat e ujit të lëshuara nga kompania rajonale e ujit "Mitrovica", për konsumatorët e Mitrovicës së Veriut. Ministri i MAPL, Goran Rakiq kishte arsyetuar pagesën, duke thënë se ajo ishte bërë pas një kërkesë nga ana e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe pas një marrëveshjeje mirëkuptimi, e cila ishte nënshkruar nga ish-ministrja e MAPL. Në lidhje me këtë ministri Rakiq kishte shtuar se mënyra e pagesës nuk kishte pasur ndonjë qëllim të keq, por për të tejkaluar problemin të cilin e ka kompania e ujit "Mitrovica".

Një çështje tjetër e ngritur nga ky komision në mbledhjen e 22 shtatorit, ishte zbatimi i integritetit të pjesëtarëve të komunitetit serb në institucionet e Kosovës.²⁷ Në kuadër të shqyrtimit të Raportit të Auditimit për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit për vitin 2019, kryetari i komisionit z.Bedri Hamza kishte përmendur të gjeturat e auditorit për mos vijueshmërinë në punë të 20 punëtorëve në këtë ministri, të cilët janë paguar nga buxheti i Kosovës. Ministri Jevtiq i ftuar në këtë mbledhje kishte sqaruar para anëtarëve të komisionit se vendimi për këtë rrjedh nga dakordimet e Brukselit. Ai kishte shtuar se ministria e kishte respektuar vendimin e qeverisë dhe kjo assesi nuk ka qenë vendim i ministrisë të cilën e përfaqëson ai. Në këtë takim, dhanë sqarime edhe përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit e cila ishte po ashtu e ftuar në këtë mbledhje kishte theksuar se çështja e punëtorëve pa vijueshmëri në punë ishte problem në kuadër të qeverisë, duke kërkuar që kjo ministri të ndërmarrë veprime që kjo mos të përsëritej.

Tema e fundit që u ngrit në këtë komision lidhur me dialogun ishte çështja e pronave, temë kjo që po diskutohet në takimet e Brukselit në kuadër të bisedimeve rreth elementeve të marrëveshjes finale. Komisioni kishte përmendur shkurtime të çështjen e pronave të Postës së Kosovës, gjatë raportimit të ushtruesit të detyrës së kryeshefit të Postës së Kosovës, z. Xhevdet Smakiqi me 15 dhjetor 2020.²⁸ Ai i kishte njoftuar anëtarët e komisionit se vetëm në veri të Kosovës, 19 nga pronat e Kosovës që nga viti 1999 shfrytëzohen nga Posta shtetërore e Serbisë.

24 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-25735/>

25 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-punesim-26079/>

26 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/komisioni-per-mbikëqyrjen-e-financave-publike-25324/>

27 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-mbikëqyrje-te-f-25723/>

28 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-komisioni-per-mbikëqyrjen-e-financave-pub-26406/>



3.5 Komisioni për Integritet Evropiane

Gjatë legjislaturës së shtatë, Komisioni për Integritet diskutoi rreth dialogut në dy mbledhje të tij nga gjithsej 15 mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe. Tema të diskutimit ishin zotimet e Uashingtonit dhe Asociacioni i komunave me shumicë serbe.

Me 22 tetor ky komision ngriti çështjen e dialogut gjatë raportimit të ministres së jashtme znj. Meliza Haradinaj.²⁹ Me këtë rast anëtarët e komisionit e pyetën ministren lidhur me moratoriumin në organizata ndërkombëtare dhe njohjen formale nga Izraeli pjesë këto të marrëveshjes së Uashingtonit. Ministria u përgjigj se ishin duke e shfrytëzuar moratoriumin për përgatitje për aplikim në organizata pas një viti. Ndërsa lidhur me njohjen nga Izraeli ajo kishte thënë se janë në komunikim me autoritetet izraelite dhe se shpejti pritet një vizitë e saj atje.

Komisioni ngriti temën e dialogut edhe në mbledhjen e 23 tetorit gjatë takimit me Shefin e Zyrës dhe Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovës, Tomáš Szunyog në lidhje me Raportin për Kosovën 2020 të publikuar nga Komisioni Evropian.³⁰ Anëtarët e komisionit e pyetën shefin e BE-së lidhur me deklaratat e Lajcak lidhur me ndryshimet kushtetuese për Asociacionin dhe shtetet jo njohëse. Ai ishte përgjigjur se ndryshimet kushtetuese mund të implikohen nga marrëveshja finale për të dy shtetet. Ndërsa lidhur me Asociacionin kishte theksuar se Kosova e ka obligim që t'a themelojë dhe të propozojë vet hapat se si do të themelohet ky mekanizëm.

3.6 Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Edhe komisioni për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes e ka ngritur çështjen e dialogut me Serbinë në dy nga 18 mbledhjet e mbajtura. Fokus i diskutimeve rreth dialogut kanë qenë ndërhyrjet e pjesëtarëve serb në territorin e Kosovës dhe zotimet e Uashingtonit.

Me 12 gusht 2020 ky komision diskutoi për zhvillimet në fsha-

tin kufitar me Serbinë, Karaçevë, fshat në të cilin kishin hyrë disa pjesëtarë të forcave të sigurisë së Serbisë.³¹ Anëtarët e komisionit kishin shprehur shqetësimet e tyre për cenimin e territorit të Republikës së Kosovës nga ana e forcave serbe, duke kërkuar vigjilencë dhe ushtrim të përgjegjësisë ligjore nga ana e organeve të rendit dhe të sigurisë së Kosovës. Komisioni gjithashtu kishte diskutuar mundësitë për të marrë informacione shtesë dhe sqarime nga bartësit e përgjegjësisë shtetërore të sektorit të sigurisë dhe të mbrojtjes, në mënyrë që të kishte një pasqyrë më të qartë lidhur me këtë rast. Për tu informuar rreth kësaj teme komisioni kishte ftuar edhe ministrin e Punëve të Brendshme dhe drejtorin e Policisë së Kosovës, mirëpo të njëjtit nuk i ishin përgjigjur pozitivisht ftesës.

Lidhur me dialogun, komisioni kishte realizuar edhe një vizitë në terren me 27 tetor 2020, në pikën e kalimit kufitar me Serbinë në Merdare.³² Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i ligjvënësve lidhur me nivelin e zbatimit të marrëveshjeve Kosovë-Serbi që prekin çështjet kufitare mes dy shteteve. Anëtarët e Komisionit u informuan nga komandanti i kësaj pikë kufitare lidhur me zbatimin e pikës së marrëveshjes së Uashingtonit e cila parasheh operacionalizimin e objektit të pikëkalimit të përbashkët kufitar në Merdare. Shqetësimi kryesor mbetej mungesa e vendosjes së komunikimit në mes të palëve siç e parashohin marrëveshjet, edhe pse pala serbe kishte kaluar në objektin e përbashkët kufitar.

3.7 Diskutimet rreth dialogut në komisionet tjera

Komisionet parlamentare që ngritën temën e dialogut vetëm në një nga mbledhjet e tyre ishin si më poshtë:

Komisioni për Buxhet dhe Transfere: Ky komision ngriti çështjen e dialogut në vetëm një nga 35 mbledhjet e mbajtura. Konkretisht, në mbledhjen e 25 nëntorit, ky komision ngriti çështjen e dialogut në kuadër të pikës së rendit të ditës ku u shqyrtua Raporti vjetor financiar i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT për vitin 2018 dhe 2019.³³ Anëtarët e komisionit kishin pyetur përfaqësuesit e -it nëse në pjesën veriore po paguhet energjia elektrike e shpenzuar

29 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/mbledhja-e-komisionit-per-integrime-evropiane-26025/>

30 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-takimi-i-komisionit-per-integrime-evropia-26037/>

31 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ceshtjet-e-sigu-25579/>

32 Shih detajet e kësaj vizite në, <http://www.votajme.org/Public/DialogActivity/Detail/470>

33 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-komisioni-per-buxhet-dhe-transfere-26262/>



nga qytetarët atje. Përfaqësuesit e KOSTT-it i kishin njoftuar anëtarët e komisionit se energjia e shpenzuar atje mbulohej nga KOSTT dhe se humbjet mujore në veri janë rreth 2.5 milionë Euro.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim: Edhe ky komision ngriti temën e dialogut në vetëm një nga 10 mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj legjislature. Me 28 tetor 2020 kjo temë u ngrit gjatë raportimit të ministrit për Kthim dhe Komunitete Dalibor Jevtiq, mbi punën e ministrisë që ai udhëhiqte.³⁴ Ministri Jevtiq kishte njoftuar anëtarët e komisionit lidhur me çështjen e të zhvendosurve, temë kjo që po diskutohej në kuadër të dialogut të Brukselit për elementet e marrëveshjes finale Kosovë-Serbi. Ministri kishte vënë në dukje se kthimi i personave të zhvendosur nuk po vazhdonte në një nivel të lakmueshëm, sipas tij për shkak të situatës së përgjithshme politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë. Ai kishte njoftuar anëtarët e komisionit se ministria ka iniciuar hartimin e Ligjit të ri për Kthimin, i cili synon ta bëjë këtë kthim sa më të lehtë për të gjithë personat e zhvendosur që kanë lënë Kosovën dhe tani dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në Kosovë.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit: Edhe ky komision ka ngritur çështjen e dialogut në vetëm një nga 28 mbledhjet që ka mbajtur gjatë kësaj periudhe. Me 22 shtator anëtarët e komisionit ngritën temën e dialogut pas deklaratave të zyrtarëve serb dhe të Bashkimit Evropian që Kosova duhej të gjente modalitete për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.³⁵ Për të kuptuar qëndrimin e qeverisë rreth kësaj çështje komisioni vendosi që të ftonte në raportim kryeministrin e Avdullah Hoti. Mirëpo ky i fundit nuk iu përgjigj ftesës së komisionit për raportim rreth kësaj teme.

Komisioni për Bujqësi, Pylttari, Zhvillim Rural, Infrastruktura dhe Mjedis: Tema e dialogut u ngrit në një nga 11 mbledhjet e këtij komisioni. Në mbledhjen e 6 tetorit raportoi Ministri i Infrastruktura Arban Abrashi, lidhur me marrëveshjen për normalizim ekonomik mes Kosovës dhe Serbisë, me fokus tek ndërtimi i akseve rrugore dhe hekurudhore.³⁶ Anëtarët e komisionit kërkuan nga ministri detaje lidhur me projektet infrastrukturore nga marrëveshja e Uashingtonit. Në këtë drejtim ministri i njoftoi anëtarët e komisionit se projektet nga kjo marrëveshje ishin lidhur me ndërtimin e akseve rrugore dhe

linjave ajrore, si ndërtimi i autostradës Besi deri në Merdare, projekt ky i cili ishte i gatshëm për implementim. Si dhe ndërtimi i hekurudhës nga Prishtina në Merdare. Projektet tjera që buronin nga kjo marrëveshje ishin ndërtimi i hekurudhave nga jugu në veri, rehabilitimi i rrjetit të hekurudhave nga perëndimi në lindje, mundësia që Kosova të ketë dalje në detin Adriatik, mundësia për ndërtimin e autostradës nga Bresalci në Dheun e Bardhë dhe projekte zhvillimore për Brezovicën. Anëtarët e komisionit kërkuan nga ministri që lidhjet rrugore dhe hekurudhore me Serbinë të mos bëheshin në linjat e kërkuara nga Serbia e cila synon ndarjen e veriut. Si dhe sqarime për burimet e financimit për këto projekte infrastrukturore.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Edhe ky komision trajtoi çështjen e dialogut me Serbinë në një nga 20 mbledhjet e mbajtura. Me 19 maj 2020 kur për raportim ishin drejtori i SHSKUK-së Basri Sejdiu dhe drejtori i IKSHP-së Naser Ramadani, u ngrit çështja e shëndetësisë paralele në veri.³⁷ Anëtarët e komisionit pyetën përfaqësuesit e shëndetësisë lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë në veri. Ndërsa, këta të fundit njoftuan komisionin se IKSHP nuk menaxhonte me veriun, por vetëm merrte nga atje informata statistikore.

34 Shih këtë mbledhje në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-dhe-26073/>

35 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-legjislacion-ma-25744/>

36 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-bujqesi-pylttar-25876/>

37 Shih më shumë në, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-komisioni-per-shendetesi-dhe-mireqenie-so-24987/>



SHTOJCË

Dialogu në Seanca gjatë Legjislaturës së Shtatë



TABELA 1.1 Diskutimet rreth Dialogut në seancat e Legjislaturës së shtatë 2019-2020

Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
1	3 shkurt 2020	Plenare	Diskutim		Albin Kurti e përmend dialogun gjatë ekspozesë së tij si kandidat për Kryeministër
2	2 mars 2020	E jashtëzakonshme	Rend Dite	Debat parlamentar në lidhje me paralajmërimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, për heqjen e tarifës 100%;	
3	11 mars 2020	E jashtëzakonshme	Rend Dite	Debat parlamentar në lidhje me rrezikimin e marrëdhënieve diplomatike të Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si pasojë e qasjes shpërfillëse e joserioze të kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me këshillat e udhëzimet e përfaqësuesve të SHBA-ve;	Çështja e masave tregtare ndaj Serbisë;
4	15 mars 2020	Plenare	Rend Dite	Miratimi i rezolutës lidhur me bisedimet me Serbinë;	U diskutua Dialogu në përgjithësi dhe përfundoi me miratimin e kësaj Rezolute;
5	25 mars 2020	Plenare	Diskutim		Gjatë seancës për mocionin ndaj Qeverisë Kurti u ngritë çështja e dialogut me Serbinë në përgjithësi;
6	3 qershor 2020	E jashtëzakonshme	Diskutim		Gjatë zgjedhjes së Qeverisë së re u ngritë çështja e dialogut me Serbinë në përgjithësi;





Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
7	4 qershor 2020	Plenare	 Diskutim		Në kuadër të diskutimeve për pandeminë u përmendën raportet me Serbinë në përgjithësi;
8	11 qershor 2020	Plenare	 Diskutim		Në kuadër të diskutimeve për pandeminë u përmendën raportet me Serbinë dhe çështja e reciprocitetit;
9	23 qershor 2020	Plenare	 Rend Dite	1. Interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, 2. Raportim i kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi;	Dialogu në përgjithësi;
10	9 korrik 2020	Plenare	 Rend Dite	Votimi i Propozim-rezolutës nga Raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe debati parlamentar lidhur me dialogun Kosovë-Serbi;	Nuk është miratua rezoluta;
11	24 korrik 2020	Plenare	 Rend Dite	Informatë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, lidhur me dialogun Kosovë-Serbi;	Dialogu në përgjithësi;
12	17 shtator 2020	Plenare	 Rend Dite	Raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi;	Dialogu në përgjithësi;
13	21 shtator 2020	Vazhdim i seancës plenare	 Rend Dite	Konsultime për harmonizim të rezolutës nga raportimi i kryeministrit Hoti përkitazi me dialogun Kosovë-Serbi;	Dialogu në përgjithësi;
14	25 shtator 2020	Vazhdim i seancës plenare	 Rend Dite	Propozim-rezoluta nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi;	Nuk u miratua rezoluta;
15	8 tetor 2020	Vazhdim i seancës plenare	 Rend Dite	Votimi i Propozim-rezolutës nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi;	Nuk u miratua rezoluta;



Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
16	9 tetor 2020	Plenare	 Diskutim	Raportimi i Kryeministrit të Kosovës, z. Avdullah Hoti, për punën 100-ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës;	Gjatë raportimit, Kryeministri njoftoi mbi punën e tij lidhur me dialogun. Ndërsa, deputetët ngritën çështjen e përbërjes së delegacionit, platformës dhe të ngjashme;
17	12 tetor 2020	Plenare	 Rend Dite	Interpelancë me Kryeministrin e Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Besa Ismaili-Ahmeti, mbështetur edhe nga 8 deputetë të GP të PDK-së, në lidhje me përgjegjësitë në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel lidhur me punën e grupeve teknike;	Gjatë interpelancës, u ngritën çështje që janë diskutuar në kuadër të procesit të dialogut që po zhvillohet në Bruksel, përkatësisht lidhur me personat e pagjetur dhe temave tjera të ngritura në këtë fazë. Po ashtu, diskutime mes Kryeministrit dhe deputetëve u zhvilluan edhe lidhur me disa nga temat që preken nga marrëveshja e arritur në Uashington;
18	16 tetor 2020	Vazhdim i seancës plenare	 Rend Dite	Votimi i Propozim-rezolutës nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi;	Nuk u miratua rezoluta;
19	21 tetor 2020	Plenare	 Rend Dite	Interpelancë me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me pezullimin njëvjeçar i aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare;	Lidhur me moratoriumin për anëtarësim në organizata;
20	21 tetor 2020	Plenare	 Rend Dite	Interpelanca me kryeministrin Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përfshirjen e Republikës së Kosovës në "Zonën e mini-Shengenit ballkanik;	Diskutimet për Mini Shengenin nga zotimet e Uashingtonit;



Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
21	21 tetor 2020	Plenare	Rend Dite	Interpelanca me kryeministrin Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me deklarin dhe qëndrimin e kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe;	Tema e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe;
22	29 tetor 2020	Vazhdim i seancës plenare	Rend Dite	<p>Votimi i Propozim-rezolutave:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z.Avdullah Hoti në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi; Nga interpelanca me Kryeministrin e Republikës së Kosovë, Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me pezullimin njëvjeçar i aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare; Nga interpelanca me Kryeministrin e Republikës së Kosovë, Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përfshirjen e Republikës së Kosovës në "Zonën e mini-Shengenit ballkanik; Nga interpelanca me Kryeministrin të Republikës së Kosovë, Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me deklarin dhe qëndrimin e Kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe; 	Rezolutat nuk u votuan për shkak të mungesës së kuorumit;
23	2 nëntor 2020	Vazhdim i seancës plenare	Diskutim	Debat parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për tu kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës;	Rikthimi i banorëve shqiptarë në veri;





Nr.	Data	Seanca	Rend Dite/Diskutim	Pikat	Çështjet e Diskutimit
24	3 nëntor 2020	Vazhdim i seancës plenare	Diskutim	Debat parlamentar në lidhje me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që të mbaj të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidale në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur;	Të pagjeturit;
25	19 nëntor 2020	Vazhdim i seancës plenare	Rend Dite	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen "Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur;	Të pagjeturit;
26	27 nëntor 2020	Vazhdim i seancës plenare	Rend Dite	Votimi i propozim rezolutave lidhur me: 1. Raportimin e kryeministrit Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi; 2. Përgjegjësitë e kryeministrit Hoti në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel, lidhur me punën e grupeve teknike; 3. Pezullimin njëvjeçar të aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare; 4. Përfshirjen e Republikës së Kosovës në "Zonën e mini-Shengenit ballkanik"; 5. Deklarimin dhe qëndrimin e kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe; 6. Trajtimin e dëmshëm të temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur;	Rezolutat nuk u votuan për shkak të mungesës së kuorumit;
27	9 dhjetor 2020	Seancë e veçantë	Diskutim	Seancë e veçantë me rastin e Ditës ndërkombëtare të përkujtimit dhe nderimit të viktimave të krimeve të gjenocidit, si dhe parandalimi i këtij krimi (A/RES/69/323);	Gjatë diskutimeve lidhur me viktimat e krimeve të gjenocidit, nga deputetët por edhe folësit në këtë seancë u ngrit në disa raste çështja e dialogut, nevoja për përfshirjen e temës së të pagjeturve në këtë proces dhe kërkesën që dialogu të zhvillohet vetëm për njohje dhe të ngjashme;





Pyetjet Parlamentare gjatë Legjislaturës së Shtatë



TABELA 1.2 Pyetjet parlamentare rreth dialogut gjatë Legjislaturës së shtatë














DEPUTETI/JA	DREJTUAR PËR	PËRGJIGJUR	TEMA E PYETJES
 Ariana Musliu-Shoshi - PDK	 Avdullah Hoti		Mundësia e vjedhjes së dokumenteve rreth dialogut në Bruksel
 Mimoza Kusari-Lila - LVV	 Avdullah Hoti	 	Mini -shengeni Mini -shengeni
 Fitore Pacolli- Dalipi - LVV	 Avdullah Hoti	   	Të pagjeturit Moratoriumi për anëtarësim në organizata Shkëmbimi i territoreve Takimi në Uashington




TABELA 1.4 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	4 mars 2020	Diskutim	Diskutim lidhur me Planin e punës së komisionit për vitin 2020;	U diskutua për rekomandimet që KDI i ka dërguar Komisionit për të përfshirë çështjen e dialogut në planin e punës;
2	11 mars 2020	Rend Dite	Raportim i z. Glauk Konjufca, ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.	Ministri raportoi edhe për dialogun me Serbinë dhe fushatën e çnjohjeve nga Serbia;
3	17 qershor 2020	Rend Dite	Shqyrtimi i ftesës së Komisionit drejtuar Kryeministrit për të raportuar lidhur me 'zotimin' e Qeverisë për pezullimin e angazhimit të RKS në organizata ndërkombëtare dhe vizitën e tij në Uashington para udhëtimit të tij në SHBA.	Nuk u realizua.
4	15 korrik 2020	Diskutim	Shqyrtimi i draft - Planit të Punës së Komisionit për vitin 2020	U ngrit edhe çështja e dialogut në përgjithësi;
5	28 korrik 2020	Rend Dite	Raportim i ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës znj. Meliza Haradinaj-Stublla	Ministrja ngriti edhe çështjen e dialogut në përgjithësi;
6	8 dhjetor 2020	Diskutim	Takim me Komisionin për Politikë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	Mbështetjen e Shqipërisë për çështjen e Kosovës, përfshirë edhe në organizatat ndërkombëtare dhe miratimin e një rezolute në kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet së cilës dënohet gjenocidi i shtetit serb ndaj qytetarëve shqiptarë;




TABELA 1.5 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Nr.	Data	Rend Dite/Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	11 mars 2020	Diskutim	Çështja aktuale e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës I ftuar: Z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit.	Gjendjen e gjyqësorit në veri të vendit;
2	13 maj 2020	Diskutim	Diskutim lidhur me ndarjen e mjeteve në vlerë 10 milionë euro nga ana e Qeverisë së Kosovës për pagesën e shpenzimit të rrymës në veri të Kosovës	Lidhur me ndarjen e mjeteve në vlerë prej 10 milionë euro nga ana e Qeverisë për pagesën e shpenzimit të rrymës në veri të Kosovës;
3	19 maj 2020	Rend Dite	Diskutim lidhur me ndarjen e mjeteve në vlerë prej 10 milionë euro nga ana e Qeverisë së Kosovës për pagesën e shpenzimit të rrymës në veri të Kosovës. Të ftuar, përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike (KOSTT);	Shpenzimet e energjisë elektrike në veri;
4	22 korrik 2020	Vizitë në terren	Veri	Vizitë në terren në veri lidhur me pengesat në ndërtimin e shtëpive për shqiptarët;
5	30 shtator 2020	Diskutim		Të pagjeturit dhe pengesat në ndërtimin e shtëpive për shqiptarët në veri;
6	7 tetor 2020	Rend Dite	Takim në Komision lidhur me çështjen e personave të pagjetur në kuadër të dialogut me Serbinë Të ftuar: Avdullah Hoti KM, Meliza Haradinaj - Stublla MPJ dhe Selim Selimi MD ; Takim në Komision me përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur;	Kryeministri Hoti dhe MPJ Meliza Haradinaj nuk i janë përgjigjur ftesës;



Nr.	Data	Rend Dite/Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
7	28 tetor 2020	Diskutim	Raportimi i Ministrit për Kthim dhe Komunitete, Dalibor Jevtiq, mbi punën e ministrisë për vitin 2020.	Personat e zhvendosur;
8	9 nëntor 2020	Rend Dite	Raportimi i kryeministrit Hoti lidhur me çështjen e të pagjeturve në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi	Të pagjeturit;
9	20 nëntor 2020	Rend Dite	Çështja e gërmimeve të fundit në Serbi për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur nga lufta në Kosovë; Shqyrtimi i draft-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjetra në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për t'u kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës;	Të pagjeturit;
10	9 dhjetor 2020	Vizitë në Veri	Varrezat masive në veri;	Të pagjeturit;
11	11 dhjetor 2020	Diskutim	Takim në komision me përfaqësuesit e fshatrave Krush e Madhe dhe Krush e Vogël, i pranishëm do të jetë edhe Avokati i Popullit	Të pagjeturit;




TABELA 1.6 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	25 shkurt 2020	Diskutim	Diskutim lidhur me detyrat me prioritet dhe organizimin e punës së Komisionit	Monitorimi i procesit të dialogut në Planin e punës;
2	3 mars 2020	Diskutim	Raportim i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE, lidhur me "Përshtatjen e rregullta vjetore për të hyrat e lejuara maksimale (MAR), që do të mbulohej nga operatorët e rregulluar në sektorin e energjisë elektrike	Marrëveshja e energjisë;
3	26 maj 2020	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2019;	Marrëveshja e energjisë;
4	9 qershor 2020	Diskutim	Formimi i Grupit të punës për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT;	Zgjedhja e e bordit të KOSTT dhe mundësia e apelit nga Serbia lidhur me marrëveshjen me ENTSO-E;
5	26 qershor 2020	Diskutim	Shqyrtimi i ftesës në raportim të bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), së bashku me kryeshefen e Telekomit të Kosovës.	Lidhur me çështjen e mundësisë së blerjes së IPKO nga Telekom Serbia;
6	21 korrik 2020	Diskutim	Raportim i bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, lidhur me blerjen e kompanisë IPKO;	Lidhur edhe me çështjen e mundësisë së blerjes së IPKO nga Telekom Serbia;
7	22 shtator 2020	Diskutim		Përmbushjen e kodit shtetëror +383;
8	6 tetor 2020	Diskutim		Lidhur edhe me çështjen e mundësisë së blerjes së IPKO nga Telekom Serbia;
9	28 tetor 2020	Diskutim	Raportim ministrit të tregtisë dhe industrisë Vesel Krasniqi	Mos respektimi i marrëveshjes së CEFTA-s nga ana e Serbisë;



TABELA 1.7 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	26 qershor 2020	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2019	Faturat e shpenzimeve të ujit në Veri;
2	22 shtator 2020	Diskutim	Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019.	Mos vijueshmëria në punë e 20 punëtorëve nga komuniteti serb në këtë ministri;
3	15 dhjetor 2020	Diskutim	Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2019, për Postën e Kosovës	Çështjen e pronave të Postës së Kosovës, ku sipas tij vetëm në veri që shfrytëzohen nga Posta shtetërore e Serbisë;



TABELA 1.8 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	12 gusht 2020	Diskutim	Raportimi i Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Gjeneral lejtënant Rrahman Rama ka raportuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë	Zhvillimet në fshatin kufitar me Serbinë, Karaçevë, në të cilin hynë disa pjesëtarë të forcave të sigurisë së Serbisë;
2	27 tetor 2020	Vizitë në terren	Vizitë në Merdare	Vizitë në pikëkalimin kufitar në Merdare bashkë me KDI-në;



TABELA 1.8 Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Integritet Evropiane

Nr.	Data	Rend Dite/ Diskutim	Pika	Çështja e Diskutimit
1	22 tetor 2020	Diskutim	Raportimi i znj.Meliza Haradinaj - Stublla, Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporë;	Lidhur me moratoriumin në organizata ndërkombëtare dhe njohjen formale nga Izraeli;
2	23 tetor 2020	Diskutim	Takim me Shefin e Zyrës dhe Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovës, Tomáš Szunyog në lidhje me Raportin për Kosovën 2020 të publikuar nga Komisioni Evropian;	Asociacionin e komunave me shumicë serbe;



|||||

|||||

